



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:186679

Datë: 22.02.2024

Numri i dokumentit: 05361924

PAKR.nr.677/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Krime të Rënda me kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Xhevdet Abazi kryetar i kolegjit, Kadrije Goga Lubishtani dhe Hashim Çollaku - anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Blerina Sallauka, në çështjen penale kundër të akuzuarit D.K për shkak të veprës penale dhunim nga neni 227 par.4 nënpar.4.1 lidhur me par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së) dhe veprës penale në bashkëkryerje vrasje e rëndë nga neni 173 par.1 nënpar. 1.3 dhe 1.4 të KPRK-së, si dhe kundër të akuzuarit A.S për shkak të veprës penale ndihmë në kryerjen e dhunimit nga neni 227 par.4 nënpar. 4.1 lidhur me par. 1 dhe nenin 33 të KPRK-së dhe veprës penale në bashkëkryerje vrasje e rëndë nga neni 173 par.1 nënpar. 1.3 dhe 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj- Departamenti për Krime të Rënda, mbrojtësit të akuzuarit D.K, av. Admir Salihu, mbrojtësve të akuzuarit A.S, av. Arbnora Shefkiu dhe av. Avni Ibrahim, si dhe përfaqësuesit të palëve të dëmtuara M. dhe V.O, av. Gazmend Rexhepi, të ushtruara kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda, 2022:132923 i datës 04.08.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 11.01.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.Me aprovimin e ankesave, të Prokurorisë Themelore në Ferizaj si dhe ankesave të mbrojtëseve të akuzuarve D.K, av.Admir Salihu dhe A.S, av.Arbnora Shefkiu, av.Avni Ibrahim, por edhe sipas detyrës zyrtare aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krime të

Rënda, 2022:132923 i datës 04.08.2023, ANULOHET dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë për rigjykim.

II.Pretendimet ankimore të Prokurorisë dhe ato të mbrojtëseve për bazat e tjera ankimore si dhe të përfaqësuesit të palës së dëmtuar, tani për tani janë jo lëndore.

III. Të akuzuarit, D.K dhe A.S mbeten në paraburgim, deri në një vendim tjetër nga ana e gjykatës së shkallës së parë.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj – Departamenti për të Krime të Rënda me aktgjykimin 2022:132923 të datës 04.08.2023, në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi të akuzuarin D.K për shkak të veprës penale vrasje e rëndë nga neni 173 par.1 nënpar. 1.4 i KPRK-së, e ka shpallur fajtor dhe e ka gjykuar me dënim me burgim të përjetshëm, në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 24.08.2021 e tutje, ndërsa të akuzuarin A.S për shkak të veprës penale ndihma në kryerjen e veprës penale vrasje e rëndë nga neni 173 par.1 nënpar.1.4 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, e ka shpallur fajtor dhe e ka gjykuar me dënim me burgim me kohëzgjatje prej pesëmbëdhjetë (15) vite, në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 22.08.2021 e tutje, por jo më gjatë se dënimi i shqiptuar me aktgjykim.

Të dëmtuarit V.O dhe M.O, për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Të akuzuarit janë obliguar që në emër të shpenzimeve të procedurës penale secili të paguajë shumën treqind euro (300 €), si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajnë secili shumën pesëdhjetë euro (50 €), të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Ndërsa me pikën II të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar konform nenit 363 par.1 nënpar. 1.3 të KPPK-së, të akuzuarit i ka liruar nga akuza dhe atë të akuzuarin D.K për veprën penale dhunim nga neni 227 par.4 nënpar. 4.1 lidhur me par.1 të KPRK-së, si dhe të akuzuarin A.S për veprën penale ndihmë në kryerjen e dhunimit nga neni 227 par.2 nënpar.4.1 lidhur me par.1 dhe nenin 33 të KPRK-së, meqë më asnjë provë të vetme nuk është vërtetuar se të akuzuarit kanë kryer këto vepra penale.

Shpenzimet e procedurës penale për këtë pjesë të aktgjykimit bijën barrë e mjeteve buxhetore.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë kanë ushtruar:

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Ferizaj, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit lidhur me sanksionin penal sa i përket të akuzuarit A.S, me propozimin që Gjykata e Apelit në pajtim me nenin 402 par.1 të KPP-së, të aprovoj në tërësi ankesën dhe të anuloj aktgjykimin e ankimuar dhe çështjen të ia kthej Gjykatës së shkallës së parë në rigjykim për rivendosje.

Mbrojtësi i të akuzuarit D.K, av. Admir Salihu, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe lidhur me vendimin mbi sanksionin penal, me propozimin që Gjykata e Apelit e Kosovës ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshoj aktgjykimin ose çështjen ta kthej në rigjykim.

Mbrojtësit e të akuzuarit A.S, av. Arbnora Shefkiu dhe av.Avni Ibrahim, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, me propozimin që Gjykata e Apelit e Kosovës ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshoj aktgjykimin, ashtu që të akuzuarin A.S të e liroj nga aktakuza ose çështjen ta kthej në rigjykim.

Përfaqësuesi i palëve të dëmtuara M. O dhe V.O, av.Gazmend Rexhepi, për shkak të shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të drejtë të gjendjes faktike, si dhe vendimit mbi sanksionin penal, me propozimin që Gjykata e Apelit e Kosovës ndaj të akuzuarit A.S ta vërtetoj aktakuzën e prokurorisë dhe të njëjtit t'i shqiptohet dënimi sipas nenit 31 të Kodit Penal të Kosovës për bashkëkryerje, si dhe vendimi mbi sanksionin penal ndaj të akuzuarit A.S të rritet, ashtu që t'i shqiptohet dënimi kapital.

Prokuroria e Apelit më parashtrësën PPA/L.nr.615/2023 të datës 04.12.2023, ka propozuar që të aprovohen si të bazuara ankesa e Prokurorisë Themelore Ferizaj- Departamenti për Krime të Rënda PP/L.nr.148/21 e datës 03.11.2023 dhe e përfaqësuesit të palëve të dëmtuara M.O dhe V.O, av.Gazmend Rexhepi, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj- Departamenti i Krimeve të Rënda, 2022:132923 i datës 04.08.2023, ashtu që të anulohet aktgjykimi i ankimuar dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje. Ndërsa, ankesat e mbrojtëseve të akuzuarve D.K, av.Admir Salihu dhe A.S, av. Arbnora Shefkiu dhe av.Avni Ibrahim të ushtruara kundër aktgjykimit të ankimuar të refuzohen si të pa bazuara.

Gjykata e Apelit caktoi dhe e mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPPK-së, në të cilën kanë marrë pjesë, përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarave av.Gazmend

Rexhepi, i akuzuari D.K dhe mbrojtësi i tij Admir Salihu, i akuzuari A.S dhe mbrojtësit e tij av.Avni Ibrahimimi dhe Arbenora Shefkiu, ndërsa nuk ka prezantuan Prokurori i Apelit dhe të dëmtuarit M. dhe V.O edhe pse të njoftuar me kohë dhe në mënyrë të rregullt. Gjatë seancës përfaqësuesi i të dëmtuarave av.Gazmend Rexhepi, qëndroj pas pretendimeve ankimore të ushtuar me shkrim. Mbrojtësit e të akuzuarve pasi elaboruan ankesat theksuan se mbetën në tërësi pran pretendimeve ankimore të paraqitura me shkrim, ndërsa të akuzuarit i mbështeti mbrojtësit e tyre.

Gjykata e Apelit në seancën e kolegjit, shqyrtoi shkresat e lëndës, studioi aktgjykimin e kundërshtuar konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-se dhe pasi që vlerësoi pretendimet ankimore në ankesa gjeti se:

Ankesa e Prokurorisë si dhe ato të mbrojtësve të akuzuarve janë të bazuara aktgjykimi i kundërshtuar duhet të anulohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, kurse ankesa e përfaqësuesit të dëmtuarave av.Gazmend Rexhepi tani për tani është jolëndore.

Pretendimet ankimore të Prokurorit të Shtetit

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Ferizaj pretendon se Gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, duke rënë ndesh me nenin 384 par. 2 nënpar. 2.5 i KPPRK-së, pasi që aktgjykimi i ankimuar nuk është hartuar në pajtim me nenin 369 par. 6 dhe 7 të KPPRK-së. Kjo sepse aktgjykimi i ankimuar, sipas Prokurorit është kundërthënës në vetvete dhe në kundërshtim me provat që i ka pasur Gjykata në shkresat e lëndës, përkatësisht aktgjykimi në pjesën liruese nuk ka paraqitur qartë dhe në mënyrë të plotë faktet në bazë të cilave janë liruar të akuzuarit dhe arsyet për të cilat Gjykata e shkallës së parë i ka konsideruar të pavërtetuar pretendimet e organit të akuzës lidhur me veprat penale për të cilat të akuzuarit janë liruar me aktgjykimin e ankimuar.

Po ashtu, Prokurori pretendon se Gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike kur ka ardhur në përfundimin se në veprimet e të akuzuarit D.K nuk janë manifestuar elementet e figurës së veprës penale dhunim nga neni 227 par. 4 nënpar. 4.4 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe se në veprimet e të akuzuarit A.S, nuk janë manifestuar elementet e figurës së veprës penale ndihmë në kryerjen e veprës penale dhunim nga neni 227 par.4 nënpar.4.1 lidhur me par.1 dhe neni 33 të KRPK-së.

Prokurori thekson se ekzistimi i elementeve të veprave penale të lartcekura në veprimet e të akuzuarve vërtetohet edhe përmes pamjeve të siguruara me video incizimet brenda korridorit të banesës, ku shihet se e ndjera në fillim reziston dhe shpreh qartë se nuk është e pëlqimit për të kryer aktin seksual apo për të e vazhduar atë, mirëpo i akuzuarit pavarësisht vullnetit të saj të njëjtën e dërgon me forcë në banjë lakuriq dhe po ashtu e kthen në dhomë, ndërkohë që e ndjera nuk ishte as e aftë që të jepte pëlqim për kryerjen e aktiviteteve seksuale për shkak të aftësisë së zvogëluar mendore dhe fizike, si pasojë e dhunës fizike dhe psikike të ushtruar në të nga i pandehuri dhe si pasojë e efektit të substancës T..., e cila është gjetur në trupin e të ndjerës gjatë ekzaminimit.

Ndër të tjera, Prokurori pretendon se i akuzuari A.S ka ndihmuar të akuzuarin D.K në kryerjen e veprës penale të dhunimit, duke i krijuar kushte për vazhdimin e kryerjes së veprës penale të dhunimit. Sipas Prokurorit, i akuzuari A.S këtë e ka bërë me të hyrë në banesën e të akuzuarit D.K dhe në dhomën ku tani e ndjera M.O gjendej lakuriq dhe i vëreheshin dëmtimet trupore, e pastaj duke hyrë dhe dalur disa herë përderisa bisedon gjatë tërë kohës me D., duke ndihmuar me praninë e tij kryerjen e veprës penale të dhunimit, sepse në një të anë ka krijuar siguri të kryesi i veprës, e në anën tjetër pasiguri tek viktimja.

Sipas Prokurorit, ndihma e të akuzuarit A.S ndaj të akuzuarit D.K për kryerjen e veprës penale të dhunimit po ashtu vërtetohet përmes këtyre fakteve: banesa e të akuzuarit A.S gjendet vetëm 600 metra larg banesës ku është kryer vepra penale dhe rrjedhimisht qëllimi i vetëm i qëndrimit të tij në banesën e të akuzuarit D.K ka qenë ofrimi i ndihmës, i akuzuari A.S me qëllim që të fshihen provat e veprës penale ia jap telefonin të akuzuarit D.K që të kontaktoj me kompaninë e kamerave “S.SH....”, i akuzuari A.S herë pas here kontrollon përmes vrimës së derës hyrjen në banesën në fjalë, del nga banesa për të blerë gjëra ushqimore për të pandehurin dhe veten gjatë kohës që i akuzuari D.K kryen dhunimin, si dhe nga ora 10:56 deri në orën 14:43 i akuzuari A.S bashkë me të akuzuarin D.K hyjnë në dhomë e godasin tani të ndjerën në pjesë të ndryshme të trupit, duke i shkaktuar dhimbje të mëdha fizike dhe psikike, e pastaj të njëjtën e dërgojnë në Spitalin e Përgjithshëm- Qendrën Emergjente në F... dhe largohen nga aty.

Për më tepër, Prokurori pretendon se Gjykata e shkallës së parë gabimisht ka bërë rikualifikimin juridik të veprës penale në vrasje e rëndë nga neni 173 par.1 nënpar.1.4 i KPRK-së, gjegjësisht ndihmë në kryerjen e veprës penale vrasje e rëndë nga neni 173 par.1 nënpar.1.4 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, pasi që në dispozitiv të aktgjykimit ka theksuar se i akuzuari D.K dhe e ndjera M.O kanë qenë duke bashkëjetuar dhe i akuzuari të ndjerën e ka privuar për motive të xhelozisë,

ndërsa në kualifikimin juridik nuk e cek nënin 173 par.1 nënpar. 1.3 i KPRK-së, i cili i referohet privimit nga jeta të anëtarit të familjes.

Ndërkaq, sa i përket vendimit lidhur me sanksionin penal për të akuzuarin A.S, Prokurori pretendon se Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit ka bërë shkelje ligjore të nenit 387 par.1 i KPRK-së lidhur me vlersimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese.

Pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit D.K, av. Admir Salihu

Mbrojtësi i të akuzuarit D.K, av.Admir Salihu, në ankesë fillimisht thekson se ky rast ka qenë rast me përmasa të larta të interesimit publik, Gjykata e shkallës së parë dhe Prokuroria kanë qenë të ndikuara nga mediat dhe si rrjedhojë është shkelur parimi procedural i prezumimit të pafajësisë dhe parimi kushtetues i gjykimit të drejtë dhe të paanshëm. Tutje, mbrojtja konsideron se Prokurori përmes aktakuzës është munduar të e relativizoj vrasje duke pretenduar se i akuzuari kishte kryer vrasjen për të fshehur dhunimin, pretendim ky që nuk gjeti mbështetje në prova materiale.

Lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, mbrojtja pretendon se Prokuroria në fazën fillestare të hetimeve (ditën e arrestimit) e me pas edhe Gjykata e shkallës së parë, pa asnjë arsye nuk ka përfillur rekomandimet e personelit mjekësor të datës 24.08.2021 ku është udhëzuar që të akuzuarit të i bëhet testi për narkotik dhe as deklarimin e datës 25.08.2021 të mjekut kujdestar i cili konstatoi se “...pacienti dukej pak në gjendje depresive dhe kjo dyshohet se është pasojë e përdorimit të substancave narkotike që ai dje vet i ka pohuar”, duke ndikuar kështu në mbrojtjen e tij dhe në zbardhjen e motivit të vërtetë dhe mënyrës të vrasjes, si dhe gjendjes në të cilën ka mundur të jetë i akuzuari.

Sipas mbrojtjes, marrja e një analize mbi narkotikët do të ndikonte edhe në raportin e autopsisë së viktimës ku në analizën toksikologjike të viktimës është detektuar TH... dhe T..., ashtu që nëse të njëjtat substanca do të gjendeshin në gjakun e të akuzuarit do të mund të vinim në përfundimin logjik se viktima dhe i akuzuari kanë qenë nën ndikimin e substancave narkotike dhe vepra penale është kryer nën këtë ndikim.

Sipas mbrojtjes, ekspertiza e punuar nga ekspertët është tërësisht jo parimore dhe jo profesionale sepse është ndikuar plotësisht nga perceptimi i publikut dhe nuk ka adresuar kërkesat e mbrojtjes. Këtë pretendim mbrojtja e argumenton me faktin se ekspertiza nuk ka të dhëna të konfirmuara, ka nxjerr një histori parciale të jetës së akuzuarit, e përshkruan në mënyrë jo profesionale dhunimin seksual që e ka pësuar i akuzuari, e adreson tërthorazi raportin mjekësor të vitit 2016

ndërsa raportet e viti 2010 dhe 2021 fare, ka konsideruar gazetatat si pjesë të shkresave të cilat kanë cituar thënie të akuzuarit pa i verifikuar të njëjtat, konkluzionet i ka në kundërshtim me raportet e sistemit shëndetësor, konstatimi është i paarsyetuar dhe i pa mbështetur në analizë, si dhe i mungon lidhshmëria me kërkesën për vlerësimin e gjendjes së akuzuarit në raport me substancën narkotike në ditën kritike.

Mbrojtja konsideron se është i pakontestueshëm fakti që të akuzuarit dhe viktimat kanë histori të përdorimit të narkotikëve, bazuar në: shkresat e lëndës ku ekzistojë dokumente lidhur me historikun e tyre kriminal i cili përmban vepra penale në lidhje me narkotikë, të gjeturat në gjakun e viktimës, dëshminë e të akuzuarit A.S në të cilën ka deklaruar se gjatë qëndrimit në banesë për tri ditë kanë përdorur substanca narkotike, gjetja e substancave narkotike në vendin e ngjarjes, si dhe raportet mjekësore dhe dëshminë e doktorit A.H mbi gjendjen e të akuzuarit. Prandaj, sipas mbrojtjes mund të arrihet në përfundimin se i akuzuari edhe në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë në ndikim të narkotikëve, mirëpo për shkak të mungesës së analizave konsideron se Gjykata e shkallës së parë këtë fakt është dashur të e vlerësojë në dobi të akuzuarit.

Pretendimet ankimore të mbrojtësve të akuzuarit A.S, av. Arbnora Shefkiu dhe av. Avni Ibrahim

Mbrojtësit e të akuzuarit A.S, av.Arbnora Shefkiu dhe av. Avni Ibrahim pretendojnë se Gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, sepse aktgjykimi i ankimuar nuk e ka hartuar në pajtim me nenin 369 të KPPRK-së. Kjo sepse provat e prezantuara në shqyrtim gjyqësor nga faqe 17 deri faqe 37, më përjashtim të video incizimeve nga banesa e të akuzuarit D.K, Gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar në favor të akuzuarit A.S dhe as nuk ka cekur fare faktin që asnjë nga këto prova nuk e inkriminojnë të njëjtin.

Këtë pretendim mbrojtja e mbështet me faktin se nga dëshmitë e dëshmitarëve V.O, M. O, E.P, B.M, B.M1 dhe A.H, si dhe dëshmia e ekspertit mjeko-ligjor N.H, të cilave Gjykata ua ka falur besimin, është vërtetuar se i akuzuari A.S, nuk ka ndërmarrë veprimet më të cilat plotësohen elementet e veprës penale për të cilën është dënuar, ndërsa Gjykata nuk ka dhënë fare arsyesim lidhur me këtë pjesë.

Po ashtu, sipas mbrojtjes mos falja e besimit të mbrojtjes së të akuzuarit A. nga Gjykata e shkallës së parë, bie në kundërshtim me vetvete sepse vet Gjykata ka konstatuar raportet e ekspertizave të gjurmëve latente dhe të ADN-së, me të cilat është vërtetuar se i akuzuari A.S nuk ka ndërmarrë veprime të dhunshme ndaj të ndjerës, por i ka ndihmuar të akuzuarit D. duke krijuar kushte. Pra, mbrojtja thekson se në njërin anë Gjykata bazuar në prova materiale ka konfirmuar mos

përfshirjen e të akuzuarit A., ndërsa në anën tjetër nuk ia ka falur besimin deklaratës së A.S duke mos dhënë arsyetim se me cilat prova ka rënë në kundërshtim mbrojtja e të njëjtit.

Mbrojtja pretendon se Gjykata e shkallës së parë duke e gjetur fajtor të akuzuarin ka bërë shkeljen e ligjit penal nga neni 385 par.1.1 i KPPRK-së, sepse veprimet të cilat Gjykata pretendon se i ka ndërmarrë i akuzuari A., nuk përmbushin elementet e veprës për të cilën është dënuar. Mbrojtja konsideron se kjo shkelje e ligjit penal është bërë si pasojë e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga ana e Gjykatës së shkallës së parë.

Sipas mbrojtjes, Gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ashtu që nuk ka arsyetuar se mbi të cilat prova ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit A. manifestohen elementet e ndihmës, ndonëse nga shqyrtimi i provave dhe nga dëgjimi i dëshmitarëve nuk është vërtetuar se i mbrojturi im ka dhënë ndihmë në kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë.

Tutje, në ankesë mbrojtja citon aktgjykimin në pjesën ku përshkruhen veprimet e të akuzuarit A. dhe pretendon se shikimi në vrimën në derë nuk gjen mbështetje të asnjë nga veprimet më të cilat përkufizohet “ndihma”. Po ashtu, pretendimin e Gjykatës së përmes video incizimeve pa zë, është vërtetuar dashja dhe qëllimi i të akuzuarit A. për të i ofruar ndihmë të akuzuarit D. për kryerjen e veprës penale, pasi që sipas mbrojtjes kjo gjë nuk mund të interpretohet në dëm të akuzuarit A. për shkak se me asnjërin nga provat e tjera të administruara nuk është vërtetuar një fakt i tillë.

Mbrojtja konsideron se për të u vërtetuar fakti që i akuzuari A. duke shikuar nga vrima e derës ka pasur për qëllim të ndihmojë të akuzuarin D., do duhej të ishte paraqitur ndonjë dëshmitar i cili vërteton se janë dëgjuar zhurma nga banesa e të akuzuarit D. dhe se i akuzuari A. është munduar të i largojë apo manipulojë këto zhurma. Për më tepër, mbrojtja ngrit pikëpyetje lidhur me faktin se si Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar çështjen e ekzistimit të zhurmës për aq kohë sa asnjë provë e vetme nuk e vërteton atë, si dhe thekson faktin që sipas ekspertit mjeko ligjor tek viktima janë gjetur përmbajtje e elementit T... i cili ka efekt qetësimin.

Mbrojtja në ankesë thekson se nuk mund të pretendohet ekzistimi i elementit të qëllimit për të i ofruar ndihmë të akuzuarit D., vetëm me faktin se i akuzuari A. ka qëndruar tek banesa e të akuzuarit D. në natën kritike.

Sipas mbrojtjes, Gjykata e shkallës së parë me vlerësimin e provave materiale në faqen 32-37 të aktgjyimit të ankimuar nuk ka vërtetuar përfshirjen e të akuzuarit A., e madje nga dy CD-të me

video incizime nga banesa e të akuzuarit D. vetëm se është vërtetuar se qëllimi real i të akuzuarit A. ka qenë takimi i shokut të tij pas disa viteve, pastrimi i disa rrobave dhe konsumimi i narkotikëve, e assesi ofrimi i ndihmës. Prandaj, mbrojtja konsideron se Gjykata duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimi të ankimuar, pa arritur që qëllimin e të akuzuarit A. të e arsyetojë dhe vërtetojë me prova, ka bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Pretendimet ankimore të përfaqësuesit të palëve të dëmtuara M. O dhe V.O, av.Gazmend Rexhepi

Përfaqësuesi i palëve të dëmtuara, av. Gazmend Rexhepi, pretendimin e Gjykatës së shkallës së parë se rikualifikimin e veprës penale e ka bërë për shkak se i akuzuari A.S nuk mund të cilësohet si bashkëkryerës, e konsideron si pretendim që nuk përputhet me provat që janë administruar e as me video xhirimet që janë shikuar dhe analizuar gjatë seancave gjyqësore. Kjo sepse sipas përfaqësuesit, i akuzuari A. ka kontribuar në mënyrë të drejtë për drejtë dhe ka shprehur energji të madhe kriminale për kryerjen e veprës penale të vrasjes së tani të ndjerës M.O.

Po ashtu, përfaqësuesi citon përkufizimin ligjor të bashkëkryerjes dhe konsideron që fakti që i akuzuari A. thellësisht ka kontribuar në kryerjen e veprës penale, nuk mund të mohohet as nga provat e administruara. Këtë pretendim përfaqësuesi e mbështet në procesverbalin e datës 01.06.2023 si dhe në procesverbalin e datës 02.06.2023. Prandaj, sipas përfaqësuesit Gjykata e shkallës së parë do duhej të mbështetej në video xhirimet e marrura nga banesa e të akuzuarit D., ku shihet qartë se i akuzuari A. ka qenë bashkëkryerës i veprës penale vrasje e rëndë dhe do duhej të merrte parasysh faktin që deklarimi i datës 06.07.2023 i të akuzuarit A. është në kundërshtim me provat e administruara.

Gjithashtu, lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të drejtë të gjendjes faktike, kur veprimet e të akuzuarit A. i ka cilësuar si ndihmë duke e arsyetuar vetëm me faktin së në raportet e ekspertizave të gjurmëve latente dhe të ADN-së, nuk janë gjetur gjurmë të akuzuarit A., ndonëse thekson se i njëjti vazhdimisht e përcjellë gjendjen e vendit ku është ushtruar dhuna dhe kohë pas kohe afrohet tek dera e dhomës së fjetjes ku ishte e ndjera ndaj të cilës ushtrohej kjo dhunë. Kjo sepse Gjykata nuk ka cituar në aktgjykimin e ankimuar përshkrimin e procesverbaleve të datave 1 dhe 2 qershor 2023, ku theksohet se i akuzuari A. disa herë ka hyrë në dhomën ku gjendej zhveshur e ndjera edhe gjatë kohës kur i akuzuari D. nuk ka qenë fare në banesë.

Përshkrimin e Gjykatës së shkallës së parë në arsyetim, se i akuzuari A. ka qëndruar gjatë gjithë kohës sa është ushtruar dhunë ndaj të ndjerës nga ana e të akuzuarit D. dhe nuk ka ndërmarrë

asnjë veprim në drejtim të evitimit të dhunës, por me vetëdije ka krijuar kushte, përfaqësuesi e konsideron që nuk përputhet as me provat.

Sipas përfaqësuesit, tek i akuzuari A. janë shprehur haptas elementet objektive dhe subjektive. Ekzistimin e elementeve objektive përfaqësuesi e argumenton me faktin se i akuzuari A. ka kontribuar dhe ka ndërmarrë veprime për kryerjen e veprës penale, si dhe ka eliminuar pengesat për kryerjen e veprës penale, si pasojë e të cilave veprime vrasja ka rezultuar kaq mizore. Ndërsa, ekzistimin e elementeve subjektive e argumenton me faktin se të akuzuarit kanë qenë të vetëdijshëm për kryerjen e veprës penale, janë njohur personalisht mes vete dhe e kanë ditur pasojën që do të shkaktohej sepse viktimat ka pasur shumë thyerje dhe lëndime në trup.

Sa i përket vendimit mbi sanksionin penal, përfaqësuesi konsideron se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit A. është tepër i ulët duke pasur parasysh përshkrimin mizor të vrasjes. Për shkak se vrasja është bërë në mënyrë shumë të ngadalshme, brutale, mizore dhe pa kurrfarë konsiderate apo brengje lidhur me shkaktimin e kësaj gjendje, sipas përfaqësuesit është dashur që të akuzuarit A. të i shqiptohet dënimi me 25 vite burgim.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet e prokurorisë dhe të mbrojtëseve lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave procedurale qëndrojnë dhe se ekzistojnë shkelje të dispozitave nga neni 384 par. 2.7 lidhur me nenin 369 par.6 dhe 7 të KPP-së, si dhe shkelje të dispozitës së nenit 384 par.2.1 lidhur me nenin 361 par. 2 të KPP-së, që kushtëzojnë anulimin e aktgjykimit të ankimuar.

Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale konsistojnë në faktin se dispozitivi është i pa qartë, i pa kuptueshëm dhe jo në harmoni me dispozitat ligjore, dispozitivi i aktgjykimit nga ana e gjykatës së shkallës së parë, është ndërtuar kryesisht duke marrë për bazë motivin e xhelozisë për kryerjen e kësaj vepre penale, e cila rrethanë ka qenë përcaktuese në shpalljen fajtor dhe shqiptimin e sanksionit penal për të akuzuarin D.K, e që në fakt motivi fare nuk hynë në elementin inkriminues të veprës penale për të cilin gjykata e shkallës së parë e ka shpallur fajtor të akuzuarin, për arsye se dispozita ligjore nga neni 173 par.1 nënpar. 1.4 i KPRK-së, i referohet privimit nga jeta personin tjetër në mënyrë mizore apo dinake dhe jo për motive xhelozie. Kurse në anën tjetër është e papranueshme nga aspekti ligjor edhe rrethana në raport me pikën 1.4 të nenit 173 par.1 i KPRK-së, për arsye se nga arsyetimi i aktgjykimit nuk rezultojnë arsyet, se mbi çfarë baze gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar mizorin, pasi që një

rrethanë e tillë duhet të vërtetohet nga ekspertet e fushës përkatëse apo nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, e që në rastin konkret nuk është bërë nga ana e gjykatës së shkallës së parë.

Për rrjedhojë një dispozitiv i tillë me këtë përmbajtje të fakteve nuk është në pajtueshmëri me normën materiale të nenit 173 par.1 nënpar. 1.4 i KPRK-së, andaj kjo paraqet shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të parashikuara nga neni 384 par.2.7 të KPPK-së, që kushtëzuan anulimin e aktgjykimit, gjithashtu gjykata e shkallës së parë nuk e ka trajtuar fare dispozitën e nenit 173 par.1 pika 1.3 të KPRK-së, e cila dispozitë përcakton privimin nga jeta të anëtarit të familjes, marrë për bazë faktin se i akuzuari D. dhe e dëmtuara M. kanë bashkëjetuar dhe sipas kësaj rrjedh se raporti i tyre është dashur të vlerësohet sipas nenit 113 par.26 të KPRK-së.

Kolegji tërheq vërejtjen, se kjo mënyrë e ndërtimit të akuzës dhe me pas e ricilësuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, është hipotetike, e dykuptimshme dhe e bënë konfuz aktgjykimin. Përveç kësaj motivin e xhelozisë të inkorporuar në dispozitiv të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë e bazon në deklaratën e të akuzuarit D.K, të dhënë gjatë ekzaminimit nga ana e eksperteve në Institutin e Psikiatrisë Forenzike, e cila deklaratë është dhënë pa udhëzimet paraprake të akuzuarit dhe pa prezencën e mbrojtësit të tij dhe si e tillë ka shërbyer vetëm për përpilim e ekspertizës, e jo për tu shfrytëzuar si mbrojtje e të akuzuarit për të ardhur në përfundim se motivi për kryerjen e kësaj vepre penale ka qenë xhelozia.

Gjithashtu edhe për të akuzuarin A.S, për kundër ricilësimit të kësaj vepre penale, nuk ka dhëna arsye të qarta dhe bindes se cilat ishin veprimet e të akuzuari në drejtim të kësaj vepre penale, pasi që nga përshkrimi i arsyeve të dhëna, veprimet e tilla i vërteton vetëm nga kamerat të cilat ishin të vendosura në banese e të akuzuari D. pa ndërlidhjeje me prova të tjera konkret që përbejnë elementin e veprës penale të ndihmës, e cila përcakton se *“Ndihma për të kryer një veprë penale përfshin, por nuk kufizohet në: dhënien e këshillave ose udhëzimeve se si të kryhet vepra penale; vënien në dispozicion të mjeteve për kryerjen e veprës penale; krijimin e kushteve ose mënjanimin e pengesave për kryerjen e veprës penale; ose premtimi paraprak se do të fshehë provat e kryerjes së veprës penale, kryesin apo identitetin e kryesit, mjetet e përdorura për kryerjen e veprës penale ose përfitimet që rrjedhin nga kryerja e veprës penale”*.

Gjykata në aktgjykim, duhet të shënoj faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale në mënyrë qartë dhe se veprimi i cili përbën elemente e veprës penale, të jetë në pajtueshmëri me tiparet e veprës penale për të cilën shpallet fajtor i akuzuari.

Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë, nuk ka zbatuar dispozitën nenit 361 par.2 të KPP-së e cila përcakton: *“Gjykata detyrohet që me ndërgjegje të vlerësojë çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, dhe në bazë të vlerësimit të tillë të nxjerrë përfundim nëse fakti konkret është provuar”*, në rastin konkret mungon vlerësimi dhe analiza provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor, përveç përshkrimit tërësor të deklarimeve të dëshmitarëve dhe provave materiale, të cilat nuk i ka krahasuar dhe lidhur me njëra tjetrën, ashtu që vlerësimi tyre është i mangët, jo i drejte dhe palogjikshëm.

Kolegji, arriti në përfundim se aktgjykimi i atakuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 2. lidhur me nenin 369 par.6 dhe 7 të KPP-së, pasi aktgjykimi nuk është përpiluar në kuptim të dispozitës se sipër cituar, në rigjykim gjykata e shkallës së parë të kujdeset që veprimet inkriminuese të akuzuarit të përfshihen në mënyrën e duhur tek norma materiale e veprave penale përfshirë këtu edhe pjesën liruese, duke pasur parasysh faktin që element e këtyre veprave penale, të jenë saktësisht të konkretizuara e të qarta. Ne rivendosje gjykata e shkallës së parë ti përmbahet vërejtjeve të lartcekura, provat e propozuara nga ana e prokurorisë si dhe ato të cilat do të propozohen nga palët në procedure të administrohen një nga një dhe në lidhmëri njëra me tjetrën, e me pas te bije vendim te drejtë dhe te ligjshëm, në raport me elementin e veprës penale të rikualifikuar nga e gjykatës së shkallës së parë të angazhoj ekspert të fushës përkatëse apo nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, gjithashtu edhe përkitazi me të akuzuarin e dyte, të jap arsye në qoftë se provohet ndihma në kryejnë e veprës penale, në qoftë se është e nevojshëm lidhur me këtë vepër penale të ftoj eventualisht dëshmitar të rinj- fqinjët se e kanë dëgjuar ndonjë zhurmë ne ditët kritike kur dyshohet se ka ndodhur ngjarja.

Pretendimet ankimore të Prokurorisë, ato të mbrojtëseve për bazat e tjera ankimore si dhe të përfaqësuesit të palës se dëmtuar mbeten jo lëndore.

Të akuzuarit D.K dhe A.S, mbeten në paraburgim deri në një vendim tjetër nga ana e gjykatës së shkallës së parë.

Nga arsyet e sipër cekura, e në bazë të nenit 402 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

Departamenti për Krime të Rënda

PAKR.nr.677/23 i datës 11.01.2024

Bashkëpunëtorja profesionale
Blerina Sallauka

Anëtarët e kolegjit:
Kadrije Goga Lubishtani

Kryetari i kolegjit
Xhevdet Abazi

Hashim Çollaku
